



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8096

Tirane, date 15.12.2015

**Drejtuar:** ZOTIT SHABAN SHETA  
SHOQERIA "BERAVA - 3" SHPK  
RRRUGA "KARL GEGA" PALLATI 3/1

TIRANE

**Për njoftim:** Z. VIKTOR DODA, DREJTOR I PERGJITHSHEM  
SHERBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR  
RRUGA E KAVAJES NR.153

TIRANE

**Lënda:** Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr. 1657 date 16.08.2013

**I nderuar zoti Sheta,**

Shoqëria "Berava - 3" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te kërkim - zbulimit nr. 1657 date 16.08.2013, për mineral kromi, ne Bashkinë Klos, Mat, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse Shërbimi Gjeologjik Shqiptar me shkresën nr.1545 date 02.11.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr. 7189 date 03.11.2015 është propozuar revokimi i lejes nr. 1657 date 16.08.2013, sepse nuk ka dorëzuar informacionet tremujore mbështetur ne piken 10 te nenit 13, piken 11 te nenit 36 qe te vërtetohej se është filluar veprimtaria e kërkim zbulimit.

Ne muajin mars 2015 nga struktura përgjegjëse Shërbimi Gjeologjik Shqiptar me shkresën nr. 363 date 02.03.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr. 2254 date 03.03.2015 ishte propozuar revokimi i lejes nr. 1657 date 16.08.2013, sepse nuk ishte filluar veprimtaria e kërkim zbulimit brenda 120 dite kalendarike nga data e hyrjes ne fuqi te lejes ne përputhje me pikën 1, te nenit 13 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Nga ana e shoqërisë u be kërkesë për mos fillimin e procedurave, pasi ishin kryer te gjitha detyrimet financiare, por nuk kishte filluar puna, sepse ishin ndeshur probleme me banoret e zonës. Ne kërkesën e shoqërisë thuhej se i kishte zgjidhur problemet me banoret kohet e fundit, pasi kishte investuar ne zhvendosjen e stanit qe ishte arsyeja e konfliktit me banoret dhe qe ishte gati për te filluar pune, kështu nga ana jone nuk u filluan procedurat për tu dhëne mundësinë qe te zhvilloni veprimtarinë e kërkim zbulimit për te cilën keni fituar te drejtën minerare.

Propozimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për revokim e lejes nr. 1657 date 16.08.2013, i përsëritur është i mbështetur ne ligjin nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin mineral ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi ju keni shkelur germën “b” te pikës 1 te nenit 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin mineral ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, qe është shkelje ligjore për te cilën një leje minerare revokohet.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin mineral ne Republikën e Shqipërisë” te ndryshuar, **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes nr. 1657 date 16.08.2013, për mineral kromi, Bashkia Klos, te Qarkut Dibër.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do merret vendimi për revokimin e lejes minerare nr. 1657 date 16.08.2013.

Ne zbatim te pikës nr.7 te nenit 13 dhe nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Mineral ne Republikën e Shqipërisë” te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e lejes se kërkim - zbulimit ne te cilën keni pasur leje minerare.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

**MINISTRI**

**DAMIAN GJINURI**

